

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave si më poshtë:**

**A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në pozicionin “Kryetare e Degës së Burimeve Njerëzore” në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave duhet të plotësoj kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të ketë përfunduar studimet e larta universitare në një nga fushat shoqërore brenda dhe jashtë vendit (sistemi i vjetër 4-vjeçar ose cikli i dytë i studimeve “Master Shkencor”).
2. Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programeve bazë të kompjuterit (Word, Excel, PowerPoint, etj).
3. Të ketë përvojë pune të mëparshme në pozicione të ngjashme administrative.
4. Të zotërojë njohuri të mira të një gjuhe të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht ose gjermanisht) të vërtetuar me dëshmi ose certifikatë përkatëse.
5. Të tregojë aftësi të mira komunikimi, bashkëpunimi në grup dhe organizimi të punës në mjedise dinamike.

**II. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si më poshtë:**

**A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në pozicionin “Sekretare mësimore” në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës duhet të plotësoj kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të disponojë diplomë të nivelit të parë “Bachelor”.
2. Të zotërojë, me dëshmi njohuri të një gjuhe të huaj perëndimore – preferohet gjuha angleze.
3. Të ketë njohuri të mira të programeve bazë kompjuterike.
4. Të demonstrojë aftësi të mira komunikuese dhe organizative në përmbushjen e detyrave të punës.
5. Të mos jetë larguar nga puna e mëparshme për arsye disiplinore.
6. Të ketë eksperiencë pune në fusha të ngjashme.

### **III. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;

3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MA);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **28.01.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.